



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e tetë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 05.09.2019, duke filluar në orën 10:10.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Predrag Stojkovic, Xhejlane Behluli Drejtori i Administratës Driton Abdyli, D.SH.P Shefkije Mehmeti, Zyrtari i Bujqësis Avdi Vllasaliu, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 13 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

**R e n d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti i korrje-shirjeve për vitin 2019;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?.

Predrag Stojkovic pasi përshendeti të pranishmit tha: unë që një kohë të gjatë nuk jam paraqitur për fjalë, nuk kam marr pjesë në votimin e vendimeve të juaja, nuk pajtohem me mendimet tuaja, po shihet sot se pse jemi thirr në këtë mbledhje të Kuvendit dhe nuk po perzihem në punen tuaj por ne i kemi vetem tri pika në rend ditë, aprovimin e procesverbalit, raportin e korrje-shirjeve dhe të ndryshme, këtu po shihet se çfar rezultati kemi, a është ndonjë pikë në interes të qytetarëve?, ne duhet të punojm për qytetarët. Në mandatin e Kryetarit Bajrush Ymerin ka punuar projekte të shumta dhe Kryetari i tanishem i Komunës në mandatin e kaluar se bashku me Kuvendin kabërë shumë investime në çdo vend, ndërsa ne tash në këtë mandat çka kemi punuar?, tash ne si Kuvend nuk po na intereson për gjendjen e qytetarëve, çdo projekt që punohet është i mirë se ardhur, çdo projekt në infrastruktur është i mirëseardhur për qytetarët pa marrë parasysh se në cilin vend punohet, por ne Kuvendi në këtë mandat më shumë kemi pasur vendime negative çdo pikë që është propozuar për rend dite nga Kryetari është terhjekur nga Kuvendi, më shumë janë terhjekur pikat nga rendi i ditës se që janë aprovuar në Kuvend.

Kryesuesi e pyeti se cilat vendime konkretisht kanë qenë negative?.

Predrag Stojkovic tha: e kemi pasur piken e statutit të Komunës që është terhjekur nga rendi i ditës, ka edhe shumë pika tjera që ki mundësi mi vertetu edhe ne procesverbale të gjithë e dim se Komuna jonë është Komunë e pazhvilluar dhe se çdo projekt është i mirëseardhur ne çdo fshatë të Komunës. Ne çdo ditë e më shumë vetem po e rrenojm punën e Kuvendit, më shumë kemi pasur pika që janë terhjekur nga rendi

## Procesverbali i Kuvendit

i ditës dhe ne sot po e lëshojm mbledhjen në shenjë proteste si dhe disa antarë dhe kryesusi janë në mbledhje vetem sa për ti marr pagat.

Mbledhjen e lëshuan antarët: Predrag Stojkovic, Jorgovanka Filic dhe Negovan Jovanovic.

Kryesuesi tha: vetem pak zt.Stojkovic, kur të bësh pyetje duhet të presesh për pergjigje sa i perket pages është për ju që i merrni 3 paga.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: unë mendoj se pikat në rend të dites duhet të formohen në bashkpunim me Drejtorit por me sa duket këtu ende nuk e dim se kush janë drejtorat, ne kemi filluar që të dergojm fëmijët në shkolla ndërsa sot Drejtori i Arsimit nuk është këtu që të na njoftoj lidhur me zhvillimin e mësimi vijues për këtë vit dhe kjo besoj se është pergjegjësi e Drejtorit të Arsimit, neglizhenca e kolegut i cili e lëshoj sallën më herët, kjo është një skandal me mos punën dhe mos angazhimin e qeverisjes lokale, ndërsa ne nuk jemi ata që vim në mbledhje vetem për paga, ne në bashkpunim me të gjithë asambleistet kemi futur rreth 14 projekte, ndërsa e kemi neglizhencen e qeverisjes që asnjë punë nuk e bënë perveq punës së vet personale dhe mendoj se edhe Drejtorat të cilët paguhen rreth 600€ pag mujore ata vazhdojnë të jetojnë në shtëpit e tyre dhe nuk paraqiten në vendin e tyre të punës duke e pasur parasysh vetem Drejtorin e Financave i cili e ka për obligim me qenë prezent për arsye të raportimeve në Kuvend, andaj me këta Drejtorat që marrin pagë e rrin në shtëpitë e tyre nuk mendoj se vendi jonë ec perpara, besoj që duhet të merremi me seriozisht dhe të marrim edhe masa të tjera duke përfshi edhe gjyqësin duke i përfshi edhe ankesat në gjykata të ndryshme sepse këta e kanë uzurpu Komunën, me këtë rend dite ne mundë të diskutojm edhe te të ndryshmet por po e kemi problem perderisa Drejtorat nuk janë prezent, ne jemi asambleista për të bërë pyetje dhe sqarime por nuk e kemi asnjë Drejtor prezent dhe kjo vazhdon edhe me Kryetarin e Komunës pasi që vetem tre herë ka qenë këtu prej kur jemi zgjedhur antarë të Kuvendit, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket bisedes paraprake të kolegut Predragut është e vertet që nuk kemi punuar si Kuvend për të mirën e qytetarëve tonë, i dina të gjitha mangësit pasi që në të gjitha Komunat ka mangësi por ka edhe perparësi, po filloj prej degjimeve publike, ne si antarë të Kuvendit e kemi pas obligim që të marrim pjesë por ju as në fshatin e juaj nuk keni marrë pjesë, ju po e akuzoni Kryetarin por Kryetari ka marrë pjesë në degjime publike si në fshatin Llabjan ashtu edhe në fshatin Pasjak, nuk jam duke e mbrojtur Kryetarin por po flitri se po i merrni paga duke mos punuar por ne si Kuvend nuk jemi duke punuar, nese nuk perfitojnë të gjithë qytetarët të pakten Kryetari i ka pru për disa qytetarë pikat e rendit të ditës. Në fshatin Llabjan asnjë prej juve nuk ka marrë pjesë në debate publike e keni pasur mundësin që ti paraqitni kerkesat Kryetarit të Komunës por as ju nuk po doni të punoni dhe nese mendoni kështu edhe unë ju bashkangjitem kolegut Predragut, punoni ju vete nese mendoni se jeni duke shkuar mirë.

Kryesuesi tha: kjo është një trysni që po i bëhet Kuvendi për arsye të buxhetit, nuk e di a ka qenë Xhejlane në mbledhjen e kaluar dhe a e ka lexuar raportin e auditorëve dhe aty janë të cekur të gjitha keqperdorimet që janë bërë dhe kjo nuk është për tu arsyetura por për tu denuar.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: e kemi pasur një paraqitje nga kolegu Predragi dhe e lëshoj mbledhjen por ai duhet të pres edhe pergjigjen e pales tjetër, të gjithë kemi të drejt të diskutojm, ne e kemi pasur raportin e auditorit që ka qenë në mënyrë katastrofike dhe të gjithë e dim se sa herë ka qenë Kryetari prezent, une nuk pajtohem me kolegun i cili e lëshoj mbledhjen pasi që edhe ne nuk mundë të aporvojm çdo pikë që vjen nga Kryetari, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: po vazhdojm me plotësimin e rendit të ditës.

Drejtoresha e Sherbimeve Publike Shefkije Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi që e dim se ne mbledhjen e pestë të Kuvendit ka qenë Plani Komunal i Veprimit për efqiencen e Energjisë dhe nuk është aprovuar pasi që së pari është duhur të aprovohet në agjensi në nivel qendror, kerkoj falje që nuk është futur në rend dite pasi që na ka arrit aprovimi prej nivelit qendror me 27 gusht por unë kam qenë në pushim andaj kerkoj nga ju që të futni në rend dite dhe të aprovohet në Kuvend Komunal pasi që aprovimin prej agjension per energji dhe efqienc e kemi marrë, ju faleminderit.

## Procesverbali i Kuvendit

Zv.kryesuesi i Kuvendit Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: unë si zv.kryesues ju njoftoj se dy antarët kanë marr leje për munges në këtë seanc të Kuvend, Zymer Zymeri dhe Jahi Zeqiri. Sa i perket diskutimeve të mëhershme dua të them diçka realiteti është ky që po shihet sikur në antarët e Kuvendit që kemi pergjegjësi edhe dikush ka pergjegjësi. Një Kryetar Komune që nuk vjen që një vit në seanc të Kuvendit nuk e di se çka të thuhet. Unë në fillim kam thënë se mundë ta mbajm seancen me një pikë në rend dite vetem që mos të humbim mbajtjen e senacave të rregullta, çdo pikë që është në harmoni me ligjin ne do ta përkrahim, sigurisht që ju kujtohet kjo pikë që kam propozuar që të tërhiqet, kam thënë që së pari të aprovohet në agjensi e pastaj të vij në Kuvend dhe kjo ka ndodhë dhe sot jam për me kalu pasi që është në pajtim me ligjin dhe ne jemi që të punojm në interes të qytetarëve, ju faleminderit.

Drejtori i Administrates Driton Abdyl pas pershendeti të pranishmit tha: e mora fjalën për tju pergjigjur zt.Gashi pasi që nuk është fer dhe nuk është mirë që të thuash se Drejtorat nuk janë paraqit pasi që ti e din se unë këtu kam qenë çdo herë, unë ballafaqohem kur dush me kend dush, ata që po dalin prej Kuvendit nuk po bëjnë mirë pasi që duhet të rrin në mbledhje dhe të bëjnë shumic, me dal prej Kuvendit nuk ka asnjë logjik kjo pune. Unë jam Drejtor i Administrates dhe pershkrim zyrtarë të detyrave të punës nuk kamë, kam qenë Drejtor i Inspektionit dhe kam punuar pa orar si wikendeve varësishhtë si kam pas punë, 150 leje i kam lëshuar, Komuna e Novobërdës nuk i ka lëshuar 150 leje prej kur egziston as nuk ka mi lshu edhe tash sa herë që ka nevoj unë jam në Kuvend se si i kryen punët antarët e Kuvendit është punë e tyre.

Kryesuesi tha: zt.Gashi kur i permendi Drejtorat e ka pas fjalën për ata Drejtorat të cilët marrin paga këtu e jetojn në Serbi.

Dobrivoje Djordjevic tha: mos të shikojm interesin e askujt as të Kryetarit, as të Nënkryetarit, nuk jam në mbrojtje të askujt, unë jam antarë i Partis Liberale edhe më heret unë ju kam lutur që ta lusim Kryetarin për një bised, nuk është qështja se kush të fitoj në fund por të shohim se kush ka të drejt. Katastrof është gjendja dhe rruga në fshatin Stanishor andaj të vazhdojm të punojmë e të mos mundohemi ta fajtësojm askend, ju faleminderit.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi e hudhi në votim propozimin e Shefkije Mehmeti.

Aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent në mbledhje 9 gjithësej që të futet në rend dite propozimi i Shefkije Mehmeti.

Më pastaj aprovohet rendi i ditës me këtë pikë shtes të propozuar: Aprovimi i Planit Komunal i veprimt për Efiqenc të Energjisë 2018-2020.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: unë e kam një vërejtje të procesverbalit të pika e dytë kur kemi votuar raportin financiar unë kam votuar kunder ndersa nuk jam i cekt aty, ceken 8 antarë kunder ndersa jan shkruar vetem 6 edhe unë kam votuar kunder dhe kerkoj që kjo të permirësohet, ju faleminderit.

Pasi nuk pati tjera vërejtje aprovohet procesverbali njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit 9 gjithësej më vërejtje të cekur me lartë.

**Pika e dytë :** Raporti i korrje-shirjeve për vitin 2019;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën ZBPZHR Avdi Villasaliu.

Avdi Villasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: korrje - shirja në Komunën e Novobërdës ka filluar me 04.07.2019 me grurë, elbë, thekër, tërshër dhe ka perfunduar me datën 07.08.2019, korrje - shirja është kryer nga 80-100 € për hektar. Në fushat të korrjes kanë marrë pjesë 18 autokombanjer të cilët kanë qenë nga Komuna jonë, nga Komuna e Kamenices, Gjilanit dhe Ranillukit. Rendimentet kanë qenë në elbë 3600kg për 1 ha, grurë 4500kg për 1ha, theker 3200kg për 1 ha dhe tershër 2500kg për ha. Siperfaqe të korrura me grur kanë qenë 720.63 ha, me elb kanë qenë 104.64ha, me theker 26.43 ha dhe me tershër 51.90. I gjithë procesi i korrje - shirjes është kryer në rregull pa ekcese, vetem se pak kane penguar kushtete atmosferike, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

## Procesverbali i Kuvendit

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: sa kan qenë të hyrat që komuna i ka perfituar prej këtyre autokombanjereve?  
Avdi Vllasaliu tha: sa i perket autokombanjerave e kan çmimin prej 100 €, nuk ka paguar asgjë as Ministria e as Komuna.

Dobrivoje Djordjevic tha: nuk me keni kuptuar, autokombanjerat a i kan paguar ndonjë taks Komunës?  
Avdi Vllasaliu tha: jo nuk kan paguar, pasi që pika në Kuvend nuk ka shkuar më kohë dhe me i obligu me pagu taks Komunale po kemi problem me autokombanjer pasi që nuk po e paguajn.

Selatin Nuhiu tha: e falenderoj zt.Vllasaliu për këtë raport shumë të mire, por këtu edhe njëher po deshmohet se ekzekutivi dhe Drejtorat sa janë serioz ndaj Kuvendit Komunal, këtu afer zyrtari Komunal është duhur që të jetë edhe Drejtori i Bujqësisë e kjo tregon se qfare serioziteti kanë si drejtorat dhe egzekutivi në raport më Kuvendin Komunal, ju faleminderit.

Pasi nuk pat tjera diskutime Kryesuesi e falenderoj Avdi Vllasaliu për raportin e paraqitur dhe kaloj në piken e radhes.

**Pika e tretë:** Aprovimi i Planit Komunal i veprimit për Efiqenc të Energjisë 2018-2020.

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen D.SH.P Shefkije Mehmeti.

Shefkije Mehmeti tha: e kemi diskutuar këtë plan në mbledhjen e pestë të Kuvendit dhe të gjithë e keni marrë materialin, por në atë mbledhje nuk është aprovuar duke e falenderuar Ramushin pasi që është duhur njëher që të mirret pelqimi në Agjension dhe në këtë pelqim e kemi marrë dhe ky plan për këtë periudh kohore mund të plotësohet dhe ndryshohet, kërkoj nga ju që ta aproveni, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: sa i perket këtij plani kemi diskutuar në seancen e kaluar, më vjen mirë që po permirsohen gjërat andaj kërkoj që ky plan të aprovohet pasi që është në interes të qytetarëve dhe çdo pikë që është në interes të qytetarëve jam për ta përkrahur, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: besoj që çdo pikë që vjen në interes të qytetarëve normal që duhet të përkrahet pavarëisht se prej cilit kandidat vjen qoft i pavarur duhet të përkrahet dhe të tregohet shembulli i bashkëpunimit se si e kemi pasur deri sot, ndërsa sa i perket pikave të ndryshme që na vin pa na argumentuar në detaje se çka kerkohet për atë pikë me kalu normalisht që nuk duhet me kalu.

Pasi nuk pati tjera diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë nga të gjithë antarët prezent 9 gjithësej dhe bihet ky:

### VENDIM

Aprovohet Plani Komunal i Veprimit për Efiqencen e Energjisë për vitin 2019-2021.

Kryesuesi kerkoj pauz 5min.

Pas pauzes Kryesuesi vazhdoj me piken e katërt.

**Pika e katërt:** Të ndryshme;

Kryesuesi tha: ju njoftoj se Kuvendi është obligativ të mbajë një degjim publik për pergaditjen e buxhetit Komunal 2020-2022, andaj nese pajtohen edhe ju e kam menduar që ta mbajm me 12 shtator ditë e enjte prej ores 10:00. Si dhe datat e mbledhjes të KPF-së dhe Kuvendit sipas planit të punës për këtë muaj i kemi ndryshuar për arsye të buxhetit komunal sepse pas aprovimit duhet të dergohet në Ministri, andaj mbledhja e KPF-së do të mbahet me 17 shtator, ndërsa mbledhja e Kuvendit me 24 shtator.

Kryesuesi i pyeti të pranishmët se a paraqitet dikush për fjalë?

Shefkije Mehmeti tha: po ju informoj rreth një qështje që ka ndodhur në Zebinc, sipas disa tiketave që kanë qenë aty VivaFresh i ka hedhur gjys ton mish të prishur afer një pronari i cili ka pasur bletë, kjo ka ndodhur të ejten e kaluar, i kemi njoftuar inspeksionin, i kemi njoftuar edhe policin dhe ne zi zyrtar të ambientit e kemi pregadit raportin dhe e kemi dorzuar në policin hetuese, pasi që aty ka pasur bleta afer ka pasur mundësi që të ndodhë ndonjë epidemi e jashtzakonshme, andaj është mirë që të njoftohen të gjithë qytetarët pasi që siç po shihet Komunën e Novobërdës po e kosiderojn si vend për hudhje të mbeturinave, nuk është hera e parë që ndodh ky rast.

## Procesverbali i Kuvendit

Dobrivoje Djordjevic tha: u permend rasti në Zebinc, por për fshatin Stanishor çfarë masa kanë marrë?, a kan dal inspektorat në Stanishor?, të dalin niher atje dhe të shikojnë se çka bëhet pasi që është tmerr dhe nuk mirret asnjë masë sikur dikush po e bënë me qëllim këtë.

Shefkije Mehmeti tha: ne kemi dal edhe në fshatin Stanishor dhe kemi parë komunitetin rom se si i hudhin mbeturinat e kemi lajmëruar rastin në polici mirëpo edhe policis po duhet më i bë presion që ti denojnë, me EcoHigjienen e kemi pastruar një herë por kot perseri është mbushur me mbeturina, ju si qytetar kur të shihni raste duke hudhur mbeturina lajmërone.

Dobrivoje Djordjevis tha: pasi që ka shumë raste të hedhjes së mbeturinave duhet të ketë më shumë inspektor që të dalin në teren, unë sa herë e kam ngrit këtë qështje kemi thënë se nuk ka mjete financiare që të ketë më shumë inspektora komunal si dhe policia duhet ti denoj të gjithë ata që hedhin mbeturina.

Driton Abdylit tha: po flas prej pervojës pasi që kam qenë Drejtor i inspektionit, në bazë të udhëzimit administrativ policia kan të drejt së pari që ti denojnë e pastaj inspektori komunal. Në fshatin Stanishor kemi pasur shumë herë aksione disa herë i kemi zan duke hedhur mbeturina i kam derguar në gjykat dhe gjykatsi më thojke se mos je duke i kaluar kompetencat e tua si Drejtor, andaj është shumë problem perderisa gjykata nuk funksionon si duhet.

Mirjana Simijonovic tha: e kam një pyetje për znj. Shefkije se çka ka ndodhur me ujësjellësin në fshatin Koretishtë?, dhe çka me rrugen alternative ne fshatin Stanishor pasi që kamionët po vazhdojnë të kalojnë në atë rrugë nga Strazha dhe Koretishta dhe fëmijet janë të rrezikuar.

Shefkije Mehmeti tha: sa i perket ujësjellësit në Koretisht që e ka marrë Hidromorava, marrëveshja është nënshkruar, por KEDSI nuk e ka lidhur rrymen për arsye të borgjit prej 2500€, 1000€ i kemi paguar por edhe 2500 € duhet të paguhen ose të bëhet një marrëveshje pasi që Komuna e ka marrë obligim që ta paguaj këtë shumë, sa i perket rruges alternative pa u aprovuar në Ministri të ambientit dhe planifikimit hapsinor depatramenti i shpronimit por ata ende nuk e kanë incu këtë procedur, ne e kemi marr vendimin dhe i kemi kryer të gjitha procedurat.

Mirjana Simijonovic tha: këtë shumë prej 2500€ të shpenzimeve të rrymes a do ti paguaj Komuna apo qytetarët, pasi që të gjithë e dim se është shumë thatësi dhe njerzit nuk po kanë ujë.

Shefkije Mehmeti tha: Kryetari i Komunës e ka marrë për obligim që ta paguaj atë borgj të rrymes, por duhet të bëhet një marrëveshje me KEDS-in pasi që 1000€ i kemi paguar në vitin 2017.

Selatin Nuhiu tha: nuk e di se a kemi të drejt që ti bëjm pyetje Shefkis pasi që nuk e dim se keni po e perfaqëson a është zëdhënse e Kryetarit apo është Drejtoresh dhe nese mundet me u pergjigj e pyes rreth ujësjellësit në Llabjan se deri ku kan shkuar procedurat?.

Shefkije Mehmeti tha: sa i perket qështjes së ujit në fshatin Llabjan jemi ende në bisedime me pronarin të cilin besoj që të gjithë e din qështjen e ujësjellësit në Llabjan.

Abdyl Gashi tha: po nderlidhem të qështja e shendetësisë por pa e anashkaluar edhe skandalin që ka ndodhur me rastin e mishit dhe hedhja e mbeturinave në fshatin Stanishor dhe gjithë teritorin e Komunës së Artanës. Unë mendoj që perveq vedijsimit të qytetarëve duhet të vedijsohen edhe Drejtorat prap këmbnguli që të vin këtu, nuk e di tash se cili është Drejtori i Inspeksionit por ai duhet ta menaxhoj situaten dhe me zgjidh mënyren më të mirë të mundshme per me parandalu dhe mi dhënë gjoba. Unë e kam pas një rast të fundit ku shkoj shpesh i vizitoj QKMF-të në Komunë dhe është gjendje e tmerrshme, pavarsisht që ndahet pak buxhet aty kam parë që nuk funksionon të Lagjja e vjeter në Artanë nuk ka oksigjen, gjendja elementare që mungon dhe e cila është e domosdoshme është oksigjeni, tjetra nuk punon kombi i ambulantes, nese ka ndonjë rast urgjend nuk kan mundësi se si ta dergojn në qendrat emergjente në Gjilan ose Prishtinë dhe kjo është pyetje për Drejtorin e shendetësisë por nuk e kemi prezent këtu dhe nuk e di se si e ndien veten një Drejtor me një gjendje të tillë. Po nderlidhem edhe me koleget që e zgjedhen një metod të protestes, por nuk është metod e protestes por metod e uljes se vetevetes të secilit asamblesit, me ardh me nënshkru ktu me thënë një fjali dhe me dal jasht, ne mundemi të protestojm për një pikë të caktuar kur nuk pajtohemi por për komplet seancën nuk mundesh mos me u pajtu.

## Procesverbali i Kuvendit

Dobriwoje Djordjevic tha: e kam edhe një pyetje për rrugen alternative pasi që është permendur se është nënshkruar një kontrat se kush do ta kryej punen kush e ka nënshkruar atë kontrat?, apo ku është ajo kontrat?.

Shefkije Mehmeti tha: nuk e di sa kesh e qarët por gurthyesit kanë thënë se ata do ta asfaltojnë rrugen alternative, ne si Komunë ja u kemi siguruar trasen dhe e kemi marrë vendimin në Kuvend, prona është e BejtaComercit që e ka marrë në shfrytëzim për 99 vjet dhe Ministria duhet të bëjë shpronsimin dhe tja paguaj pasi që ai nuk po e jep fal pronen.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.  
Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

**Valmire Mustafa**  
Procesmbajtëse

**Nebojsa Arsic**  
Kryesues i Kuvendit



*(Handwritten signature of Nebojsa Arsic)*